



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0073

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Pro Medical” SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1, me 03/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Pro Medical” SH.P.K. me nr. 2024/0073, kurse Vendimi i AK Komuna e Pejës, datës 09.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit; 635-23-13870-2-2-1, Anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues “Pro Medical” SH.P.K aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.12.2023, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1. Vendimi i AK-së për dhënie të

kontratës është publikuar me datën 09.01.2024.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 53,470.00 €.

Me 15.01.2024, OE “Pro Medical” SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 15.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pro Medical” SH.P.K, me nr. 73/24 për lidhur me aktivitetin “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Përgjigje e Autoritetit kontraktues në Kërkesën për rishqyrtim

“Përgjigja nga AK 1, ju njoftojmë se ne si AK dhe Komisioni Vlerësues ju njofton se ka vepruar konform LPP-se dhe Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ku OE te propozuar për kontrate i plotëson te gjitha kushtet e kërkuara ne DT dhe NJK Pasi qe te kriteret e vendosur ne DT dhe NJK ceket qarte se për (LOT 1) Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme në vlerë prej 14.900.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. OE i propozuar për kontratë është ne përputhje me te gjitha kushtet e DT dhe ka dhen çmimit te lire se OE ankues andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja për ketë pike janë te pa bazuara. Pretendimet e OE 2 Ne Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme si kriter ka qenë si: Sipas Interpretime te KRPP e datës 22.06.2023 citim “Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001, secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit ”Në rast konkret Udhëheqësi i GOE nuk ka ISO certifikate edhe pse është si ekzekutues i kontratës pra në këtë rast AK nuk është i sigurt se shërbimet janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit. Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 është ne kundërshtime me Neni 59.4 citim ”Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 citim “ Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të

ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve” Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra siç kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata, dhe njëherit AK duke e rekomanduar për kontratë këtë OE bie ndesh me Neni 7 të LPP dhe Neni 59.4. Përgjigja nga AK 2. OE propozuar për kontratë është në përputhje me DT dhe NJK ku OE i propozuar për kontratë është grup i konzorciumit e cila mund ti mbuloj te gjitha dokumentet sipas LPP-se, pasi qe ju qe referoheni për certifikata Sipas Interpretime te KRPP e datës 22.06.2023 citim “Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit” Ky Interpretim vlere ne qofte ne Dosjen e Tenderit vendoset Certifikatat ISO te Kërkesat e përshtatshëmrisë profesionale, atëherë do ishte me te drejt pretendimi juaj, por Certifikatat ISO janë kërkuar te Aneksi 1. Specifikimet Teknike Të Detyrueshme- OE për LOT 2 obligohet qe te dorëzojnë ne ofertën e tyre edhe: 1. OE te jete i pajisur me Certifikate ISO 9001 2018 dhe ISO 13485 2018 2. OE duhet te posedoj 1 Certifikate servisi për te paktën njërën nga pajisjet për te cilat kërkohet servis Selectra ProM ose Mindray. Qe me këtë i bije se Certifikatat mund ti dorëzoj njeri prej Grupit te konzorciumit jo veç e veç siç e parasheh Interpretimi i KRPP-se, andaj me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore ne këtë pike janë te pa bazuara.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro Medical SH.P.K”, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Te pakënaqur ndaj Vendimit te AK te dt. 09.01.2024, duke qenë palë me interes në kuptim të nenit 4 të LPP-së paragrafi 1.11 lidhur me paragrafin 1.26, kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, ku mbi bazën e provave dhe fakteve të ofruara mbi shkeljet procedurale dhe materiale të bëra ne këtë aktivitet te prokurimit, kemi kërkuar që të anulohet Njoftimi për dhënie te kontratës i dt.09.01.2024 dhe lënda te kthehet ne rivlerësim. AK- Komuna e Pejës ne aktivitetin e Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike dhe LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike ky aktivitetet i prokurimit te lartshënuar është bërë në kundërshtim me LPP ku ne më poshtë shtjellojmë pretendimet tona. Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, por ne kemi vërejtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijim do paraqesim fakte dhe sheshmit gjithashtu edhe pretendimet tona ankimore se vlerësimi nuk është bërë konfrom LPP. Neni 59. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlerësimit të ofertës të OE te rekomanduar. Kurse OE i rekomanduar në listën e kontratave të dorëzuara nuk ka asnjë kontratë për servisim dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Për kundërt, të gjitha kontratat e nënshkruara përfshijnë shërbime të mirëmbajtjes dhe kontroleve periodike të mjediseve përfshirë sistemin e nxemjes qendrore, sistemin e kondicionimit të ajrit, ventilacionin dhe sistemet sanitare dhe disa furnizime me te cilat janë jashtë natyrës te këtij aktiviteti te prokurimit si furnizime me pelet etj, shiko dëshminë e kontrata publike te bashkangjiture si dëshmi me përshkrimet sipas aktivitet te prokurimit, kurse ato me sektorin priva nuk kemi

mundësi verifikim por edhe ato janë kontrata për nxeheje qëndrore, vendtillim etj pra jashtë kësaj fushe apo aktiviteti te prokurimit. Pra ne DT ka qenë për (LOT 1) Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, Aneksin 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve. Ky aktivitet i prokurimit është lloji i kontratës 2-Shërbime mirëmbajtje, ndryshe nga ç' pretendon AK në Vendimin për refuzimin tonë të pretendimit të parë. Është e rëndësishme theksuar se në asnjërin prej tyre nuk përfshihet servisi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore apo stomatologjike. Kjo do të thotë se kontratat aktuale nuk kanë lidhje organike me shërbimet në fushën e pajisjeve mjekësore dhe stomatologjisë. Është vërejtur se këto kontrata specifike nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti i Kontratave (AK), veçanërisht në lidhje me kërkesën 1 për Lotin 1.

Kjo situatë bën të vështirë pranimin e ofertës te OE te rekomanduar nga AK, pasi Operatori Ekonomik (OE) në fjalë nuk ka përmbushur shërbimet në fushën e pajisjeve mjekësore dhe stomatologjisë për të përmbushur kërkesat e përcaktuara nga AK. Nëse këto referenca apo lista e kontratave pranohen, ka rrezik që mund të përfshijnë çdo kompani, pavarësisht nga përvoja e tyre në fushën e ndërtimit, infrastrukturës, dhe të tjera te merr kontrata ne fushat te cila nuk te specializuar dhe nuk e kane veprimtarinë adekuate dhe nuk ka kontrata te ngjashme. Kjo do të thotë se, sipas AK, mund të pranohen referenca që nuk kanë lidhje me qëllimin kryesor të aktivitetit të prokurimit. Kjo situatë do të shihej si një anomali dhe do të hapte mundësinë që OE të tjera të shfrytëzojnë këtë rast nëse PSH refuzon pretendimin tone te cekur me lart, ne besoj se PSH do të ketë parasysh ketë anomali të AK duke favorizuar një OE i cili nuk ka asnjë kontrate për Mirëmbajtjen dhe servisin e pajisjeve mjekësore, pra AK është duke tentuar te rekomandoj një OE i cili nuk ka asnjë eksperiencë dhe kontrate ne fushën pajisjeve mjekësore, kjo sipas AK do ishte sigurt një OE merr riparimin e makinave automjeteve te merr kontrate për servisin e pajisjeve mjekësore apo anasjelltas duke marr parasysh se sa sensitive janë këto pajisje mjekësore AK duhet të respektohet LPP. Termi “të ngjashme” ka kuptimin e shërbimeve me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontrata pra për shërbime për Servisimi i aparatave mjekësore apo stomatologjik kurse OE ka dorëzuar listën e projekteve për klima, ngrohje qendrore dhe ventillim etj pra nuk kane lidhje me paisje mjekësore, pra nuk kane asnjë lidhje organike dhe teknike me kontratat e OE te rekomanduar. Si mund të rekomandohet për kontratë një OE ku nuk ka plotësuar kriteret e DT dhe nuk ka asnjë kontrate lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, dhe ky veprim i AK duke pranuar kontrata e tilla janë në kundërshtime me qëllim e aktivitet te prokurimit dhe qellim e shërbimet te kërkuar për këtë aktivitet te prokurimit.

Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 1 është ne kundërshtime me neni 59.4 citim ”Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 citim “Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve” Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra

siç kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 , Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik ky OE duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata.

Pretendimi i dytë (II): Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate është OE i pa përgjegjshëm pasi qe ka ofertuar me çmime jo normalisht te ulëta, ne habitemi si AK-ne pse nuk kane vepruar konfor legjislacionit ne fuqi. Sipas Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik konkretisht neni 41 Tenderët Jo-normalisht te Ulet, neni 41.4 thuhet: "Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. AK do te veproje ne përputhje me nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te Rregullores për Prokurimin Publik sepse 41.4 ka cekur si për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 me poshtë janë çmimet manipuluese nga OE i rekomanduar për kontrate. Pra RrPP jep mundësi AK edhe nëse kushtet sipas 41.3 nuk janë plotësuar te veprojnë sipas RrPP Neni 41.4 dhe 41.9. Shihet qarte se oferta e OE te rekomanduar për kontrate dhe OE tjerë kanë ofertuar me çmime manipuluese pra janë me çmim jo normalisht e ulet është dashur menjëherë ta eliminoj këtë operator ekonomik e jo ta shpërblej me kontrate nga AK. Për qudi, edhe pse NJK ka njohuri rreth çmimeve të tregut për këtë shërbime, nuk ka ngritur asnjë shqetësim në lidhje me këtë. Ne kemi bashkangjitur paramasen dhe analizimin e çmimeve te OE te rekomanduar për disa pozicione ku kemi afruar analizim, fakte dhe prova se çmimet janë manipuluese. Shikoni çmimet për disa pozicione 35,36,37 dhe 38 si kemi listuar edhe pozionet tjera janë çmime manipulues ne pjese rreze reve por si ka mundësi pozioni 35 si Denontimi i karriges, transport dhe zhvendosja ne vend tjetër te behet vetëm me 2 euro çmimin me TVSh ose neto pas tatimit 1.53 cent kurse sa për informacion nja karrike ka mbi 230kg duhet min angazhim 3 persona vetëm për transportuar pra ngarkuar dhe zbarkuar plus shërbimet tjera siç janë cekur ne pozicionin 35. Pozicioni 36 Montim, aktivizimi dhe ndërrimi i te gjitha elementeve dhe garancioni për 3 muaj vetëm me 2 euro ose 1.53 cent me çmimin neto pas tatimit, pra montimi i unitit stomatologjik dhe aktivizimi tij për pune përfshirë servisimin e tij dhe ndriçimit e te gjitha elementeve qe duhen ndërruar pas aktivizimit te unitit 3 muaj duhet te jete garancioni i plote ne te gjitha pajisjet e unitit (shiko paramasen) do te behet vetëm me 2 euro çmimin bruto ose neto 1.53 cet, gjithashtu 37 mbështetja e karriges me lëkurë vetëm 5 euro ose 3.81 cent neto, kurse për këto shërbime ulsa duhet të çmontohet nga karrige dhe të mbështetet me lëkurë në një kompani të specializuar ku ka një kosto shtesë, ndërkaq, ky Operator Ekonomik (OE) ka ofruar vetëm një çmim bruto prej 5 euros, pozicioni 38 Servisim paketuesi vetëm me 1 euro ose neto 0.76 cent pra anomali me çmime pra enroma te ultë qe bie ndesh me RrPP pra Neni 41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet. AK duhet te këtë parasysh Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik pra Neni si: 41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet. Sektori i Stomatologjisë ka informacion se ka kushtoj këto shërbime si montimi, demonetimi dhe pjese rezerve sepse ata marr këto shërbime edhe ne sektorin privat ku këto çmime janë nen çmimin e tregut pra janë enroma te ulta, ju lutem analizoni çmimet edhe njëherë te OE te rekomanduar ku vërehet se janë çmime manipuluese. Ne si OE kemi njohuri ne hollësi për çmimin e pjesëve për karrige stomatologjike dhe paisjeve tjera stomatologjike sepse jemi importues i pjesëve rezerve për karrigeve stomatologjike dhe çmimet e ofertuar nga OE i rekomanduar janë ne çmimin e tregu dhe nuk ka mundësi te behën me këto

çmime pjesët për karrige stomatologjike shiko foto material pjesëve rezervë për karrige stomatologjike. AK ne vend qe ta eliminoj këtë OE nga ky aktivitet i prokurimit, AK e ka shpërblyer me kontrate kundërligjshëm pasi qe sipas sqarimeve te mësipërme, plotësohen te gjitha kushtet ligjore për ta eliminuar. Për (Lot 2) Kërkesa pra në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (LOT 2) Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve. Kurse GOE i rekomanduar ne listën e kontrata te dorëzuar nuk ka asnjë kontrate për Servisim dhe mirëmbajtën e paisjeve mjekësore, por te gjitha kontratat janë si: Furnizime me material mjekësore apo paisje pra nuk ka kontrata për Shërbime pra ky aktivitet i prokurimit është për Shërbime e jo Furnizime dhe këto kontrata nuk mund te pranohen nga AK pra nuk ka asnjë kontrate për Servisim e pajisjeve mjekësore apo labororit, pra nuk ka lidhje organik me këto shërbime, dhe këto kontrata si të tilla nuk pranohen nga AK.

Ky aktiviteti i prokurimi është për Shërbime në DT AK si kriteri/kërkesa në DT 9.1 & 9.2 për kontrata për Shërbime tek Kapaciteti teknik dhe professional AK vendosin: 8/9 Për (LOT 2) Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme në vlerë prej 14.900.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara.

Për (LOT 2) Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve. Pra kemi dy Lloje të kontratave si: 1 Furnizime dhe 2 Shërbime në baze LPP kemi dy lloje të kontratave pra Kontrata për shërbime dhe kontrata për furnizime pra ka dallim në mes tyre, pra shihet qartë se ka dallim ne mes Furnizimi dhe Shërbimeve kur ne rastin konkret GEO ka dorëzuar Listën e projekteve jo valid te cilat nuk mund të pranohen nga AK, GOE dorëzon Listën e projekteve për Furnizime e jo për Shërbime pra asnjë kontrate nuk ka për shërbime siç ka cekur AK ne Kërkesën 1.

Pra, AK decidivisht e ka cekur termin “kryerje të shërbimeve” tek për (LOT 2) Dëshmia 1. Pra shihet qartë se ka dallim ne mes Furnizim dhe Shërbimeve kur ne rastin konkret GEO ka dorëzuar Referenca jo valid te cilat nuk mund të pranohen nga AK. Pra Udhëheqësi grupit ose OE Genius Kosova nuk ka plotësuar kriterin së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara, pra ky OE ka vetë kontrata për furnizime siç është e cekur ne listën e projekteve me poshtë. Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 është ne kundërshtime me Neni 59.4 citim ”Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 citim “ Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”. Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra siç kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata, dhe njëherit AK duke e rekomanduar për kontratë këtë OE bie ndesh me Neni 7 të LPP dhe Neni 59.4.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 73/2024, ndërsa me datë 05.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/73 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

-Vlerësimi pretendimit OE “Pro Medical SH.P.K.” Eksperti shqyrtues përmes Raportit nr. 2024/73 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me nr. të prokurimit: "635-23-13870-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 12.12.2023, hapja e ofertave është bere me datë 27.12.2023, ndërsa njoftimi B58 publikohet me datë 09.01.2024, në të cilin vendim sipas komisionit të vlerësimit, për kontratë rekomandohet: OE Uraniku-SG SH.P.K është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne këtë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire Oferta e këtij është € 30,083.50 LOT 1. Grup i Operatorëve Ekonomik Genius Kosova Sh.P.K.; Madekos Sh.P.K. është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne këtë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire Oferta e këtij është € 7,960.00 LOT 2. Kurse OE ankuesi shpallet i pasuksesshëm. Tutje, pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues për LOT 1 kundër OE të rekomanduarit OE Uraniku- SG SHPK:

Konstatimi i parë (I): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues sqaron se, AK në DT ka përcaktuar këto kërkesa: “Për (LOT 1) Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme në vlerë prej 64.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara”. “Për (LOT 1) Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve” Në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet lista e projekteve e cila përfshinë mirëmbajtje dhe furnizim , montim, e cila në referenca përshkruhet

mirëmbajtje e nxemjeve qendrore, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit. Marrë parasysh paramasën e AK-së, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me servisim të karrikës stomatologjike gjegjësisht Destilatori, Kompresori, Autokllavi, të cilat në brendi kanë nxemëses, termostat, kompresor të ajrit, filtër i ujit etj, ku për të cilat AK lidhur me referencat për projektet e përfunduara mund ti sqaroj se nëse OE i rekomanduar ka projekte në shërbim dhe mirëmbajtje, në konsultim me njësinë kërkuese. Andaj pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit për çmime jo normalisht të ulëta, sqarojmë se, kushti i tretë konform rregullores me nr 001/2022 për prokurim publik nuk është plotësuar, për faktin se janë vetëm dy oferta, mirëpo konform 41.4 dhe 41.5 të rregullores 001/2022 për prokurim publik: 41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së; 41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët. Andaj konsideroj se AK, gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta respektoj rregulloren 001/2022 për PP, përkatësisht nenin 41.4 dhe 41.5, si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimet e OE ankues kundër OE të rekomanduarit GOE Genius Kosova SHPK dhe Madekos, për LOT 2: Për (LOT 2) Kërkesa pra Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (LOT 2) Dëshmia 1 Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve.

Kurse GOE i rekomanduar në listën e kontratave të dorëzuar nuk ka asnjë kontratë për Servisim dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, por të gjitha kontratat janë si: Furnizime me material mjekësore apo pajisje pra nuk ka kontrata për Shërbime pra ky aktivitet i prokurimit është për Shërbime e jo Furnizime dhe këto kontrata nuk mund të pranohen nga AK pra nuk ka asnjë kontratë për Servisim e pajisjeve mjekësore apo laboratorit, pra nuk ka lidhje organik me këto shërbime, dhe këto kontrata si të tilla nuk pranohen nga AK. Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimit e OE ankues kundër GOE të rekomanduarit sqaron se, AK në DT për LOT 2 ka kërkuar: Për (Lot 2) Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës së ngjashme në vlerë prej 14.900.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (Lot 2) Dëshmia 1 Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar, Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve. Kurse, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet lista e kontratave e cila përfshinë vetëm furnizime me materiale shëndetësore, barna etj, dhe asnjë shërbim për mirëmbajtje nuk e posedon, si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, ndërsa OE deklaron se pajtohet me mendimin e ekspertit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit dhe konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues e konsideron si pjesërisht të qëndrueshëm pretendimin e parë ankimor të OE ankues pasi që në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet lista e projekteve e cila përfshinë mirëmbajtje dhe furnizim, montim, e cila në referenca përshkruhet mirëmbajtje e nxemjeve qendrore, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit. Marrë parasysh paramasën e AK-së, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me servisim të karrikës stomatologjike gjegjësisht Destilatori, Kompresori, Autokllavi, të cilat në brendi kanë nxemëses, termostat, kompresor të ajrit, filtër i ujit etj, ku për të cilat AK lidhur me referencat për projektet e përfunduara mund ti sqaroj se nëse OE i rekomanduar ka projekte në shërbim dhe mirëmbajtje, në konsultim me njësinë kërkuese, ashtu si përcaktohet me nenin 69 të LPP-së” Në procedurat që shpjen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë”.

Lidhur me pretendimin për çmime jo normalisht të ulëta, sqarojmë se, kushti i tretë konform rregullores me nr 001/2022 për prokurim publik nuk është plotësuar, për faktin se janë vetëm dy oferta, mirëpo konform 41.4 dhe 41.5 të rregullores 001/2022 për prokurim publik: 41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së; 41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

Mbi bazën e këtyre konstatimeve Paneli shqyrtues ka vendosur se aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në Rivlerësim dhe obligohet Autoriteti kontraktues, që gjatë procesit të rivlersimit ti marr në konsideratë dhe veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjore të konstatuara, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE ankues, të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit në rivlerësim, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: